

Data 18.01.2024

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim interneti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 32562300-3;
72400000-4;

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,993,410 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e dhjetë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
 - b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” , në nenin 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm

nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenet e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një "kompetencë thelbësore", ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim individual/Certifikatë të lëshuar nga AKEP për shërbimin e transmetimit të internetit.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri, bazohet në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: ... kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata, në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4/a “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

Shërbimi i internetit nuk mund të ofrohet nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato të licensuara/autorizuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike Postare (AKEP), ndaj duke qenë se është në proporcion me objektin e prokurimit vlerësojmë që operatorët ekonomikë ta disponojnë këtë dokument për ushtrimin e aktivitetit në ofrimin e internetit ISP.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente me te, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë ISO 27001:2013 ose ekuivalente me te, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

Shenim: Të dy certifikatat e mësipërme të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e shërbimit të internetit pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosija e ISO 9001:2015 na shërben për të treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Ndërsa kërkesa për paraqitjen edhe të certifikatës ISO 27001:2013 arsyetohet nisur nga ajo çfarë përcakton kjo certifikatë e cila është një standard që rregullon sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Gjithashtu rregullon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë. Pranohet dhe ISO e re.

Prandaj disponueshmërinë e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e shërbimit të kërkuar, trajtimin e informacionit konfidencial të mundshëm gjatë këtij procesi dhe rëndësisë së tij, kërkesa e mësipërme është një kërkesë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga ana jonë. Të gjitha standardet e kërkuara janë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e procedurës së shërbimit të kërkuar për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës të shtrirë në kohë.

2.2.5 Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë të paktën 4 persona me kualifikimet si më poshtë:

- 1 inxhinier, i diplomuar në Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit ose në profil të ngjashme, i specializuar në fushën e "Infrastrukturës IT dhe konfigurimit të rrjetit" ose ekuivalent si pjesë e ekipit të konfigurimit të pajisjeve, siç tregohet në Termat e References.
- 3 teknik, të diplomuar në Teknologji të Informacionit ose profil të ngjashëm/kurse të specializuara, për menaxhimin e programeve kompjuterike dhe pajisjeve siç tregohet në Termat references.

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet këtij dokumentacioni:

Listë pagesa e muajit të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Diplomat dhe Certifikatat ku të jete i verifikueshem informacioni i kerkuar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten vetem nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 41, pika 4/b, c “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Kërkesa për të paktën 1 inxhinier të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent, fusha Routing & Switching bazohet në kërkesat të projektit, në termat e referencës dhe grafikut të ekzekutimit. AK kërkon të realizojë blerje shërbimi, ku përfshihet instalimi/konfigurimi dhe mirëmbajtja e tyre duke lejuar komunikimin midis qendrave të mirëmbajtjes midis tyre dhe me selinë qendrore sipas termave të referencës. Gjithashtu, sipas kërkesave të projektit, OE duhet të ofrojë sigurimin,

konfigurimin fillestar dhe funksionimin e duhur të infrastrukturës (ne kuadër te infrastrukturës tërësore te komunikimit te AGSco sha.

Gjate projektit, kërkohet te kryhen implementime dhe konfigurime te rrjetit LAN me qellim përmirësimin e rrjetit. Me konkretisht kërkohet te kryhen konfigurimet e pajisjeve switch, router, firewall etj. për segmentimin e përdorueseve si dhe integrimi i infrastrukturës se re te prokuruar. Niveli profesional ne fushën Routing dhe Seitching, garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka specialist te aftë me ekspertizën e nevojshme për te planifikuar, implementuar, integruar dhe diagnostikuar rrjetin LAN te autoritetit ne te gjitha qendrat. Nga ky aspekt disponimi minimalisht i 1 një inxhinieri (qofte për projektimin, implementimin dhe segmentimin e projektit) është domosdoshmëri e lidhur ngushte me realizimin me sukses te kontratës.

Certifikimi i stafit ne fushën e kërkuar ne nivel profesional ose ekuivalent, garanton Autoritetin se shërbimet e kërkuara do te kryhen nga një staf me njohuri te avancuara dhe te certifikuara ne përzgjedhjen, zhvillimin, implementimin dhe suportin e pajisjeve dhe funksioneve te sigurisë qe këto pajisje ofrojnë. Kjo kërkesë do te plotësohet me sigurimin dhe implementimin e pajisjeve për komunikim midis qendrave te mirëmbajtës dhe selisë qendrore, dhe shërbimeve te konfigurimit te nevojshme ne këto pajisje.

Meqenëse shërbimi do te mbuloje disa qendra me pozicione gjeografike me distancë (Tiranë, Fier, Korçë, Çorovodë) e bën te domosdoshme qe OE te disponoje gjithashtu te paktën 3 teknik si për implementimin ashtu edhe për ofrimin e shërbimit përgjatë afatit te zbatimit te kontratës. Kjo tregon që operatorët ekonomikë zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, besueshmëri, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kësaj kontrate, e provuar kjo nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar në këto dy kritere, diplomat dhe certifikatat , të cilat vërtetojnë kualifikimet përkatëse.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose te tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të

njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e Referencës dhe specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën e shërbimit dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.